



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2016

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.03.1995, ‘KODI I
PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 105 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 105

Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve

1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive, të cilat nuk janë sekret dhe nuk dëmtojnë hetimet.
2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që shqyrton çështjen ose që ka dhënë vendimin, për ato të shqyrtimit gjyqësor.
3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.”

Neni 2

Nenet 115 dhe 116 riformulohen me këtë përmbajtje:

“Neni 115

Dokumentimi i seancave gjyqësore

1. Veprimet dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv të seancës gjyqësore dhe mbajtjes së procesverbalit të përmbledhur në formë të shkruar.

2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.

3. Kur është e pamundur të realizohet regjistrimi i seancës gjyqësore, për shkak të defekteve në pajisje ose kur pajisjet nuk mund të përdoren për ndonjë arsye tjetër, kryetari i trupit gjykues urdhëron që procesverbali i seancës gjyqësore të mbahet fjalë për fjalë në formë të shkruar.

4. Procesverbali i mbajtur sipas paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni, nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe nga kryetari i trupit gjykues. Procesverbali, materiali i regjistrimit dhe transkripti i tij bashkëlidhen me dosjen gjyqësore, si pjesë përbërëse e saj.

5. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit në çdo kohë, përkundrejt pagimit të tarifave përkatëse.

6. Rregulla më të detajuara për aspekte teknike të regjistrimit të seancave gjyqësore përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 116

Përmbajtja e procesverbalit

1. Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 115, procesverbali përmban:

a) Tregimin e vendit, të vitit, të muajit, të ditës dhe të orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar seanca gjyqësore;

b) Personat që marrin pjesë, gjeneralitetet e tyre, dhe të përfaqësuesve të tyre;

c) Personat që mungojnë dhe shkaqet kur dihen;

d) Kërkesat e paraqitura nga palët;

e) Personat që marrin fjalën gjatë seancës gjyqësore shoqëruar me kohën përkatëse;

f) Çdo gjë që është e pamundur të evidentohet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv; si dhe

g) Çdo veprim tjetër procedural gjyqësor.”

Neni 3

Pas neni 116, shtohet neni 116/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 116/a

Elementët e domosdoshëm të regjistrimit audio ose audioviziv

1. Regjistrimi përmban gjithçka që ka ndodhur në seancën gjyqësore, të gjitha vendimet dhe urdhrat e gjykatës, si dhe të gjitha kërkesat, deklarimet dhe pretendimet e palëve. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.

2. Në çdo rast, regjistrimi duhet të tregojë:
- Përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit gjyqësor;
 - Gjeneralitetet e palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore;
 - Nëse është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.
3. Për dokumentimin e veprimeve procedurale gjatë fazës së hetimeve, për aq sa është e mundur, zbatohen parashikimet e mësipërme.”

Neni 4

Në fund të titullit të nenit 117, shtohet togfjalëshi “mbajtur jashtë seancës gjyqësore”.

Neni 5

Pas neni 117, shtohet neni 117/a me këtë përmbajtje:

“Neni 117/a

Përgatitja e transkriptit

- Transkripti i regjistrimit përgatitet nga sekretari gjyqësor në këto raste:
 - Nëse kërkohet nga një anëtar i trupit gjykues ose prokurori;
 - Nëse kërkohet nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, me kusht që të paguhet tarifat e vendosura për këtë qëllim.
- Transkripti i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për një pjesë të seancave, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin.
- Transkripti mund të kërkohet edhe para se gjykata të ketë dhënë vendimin për çështjen.”

Neni 6

Neni 118 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 118

Përmbajtja e transkriptit

- Transkripti përmban, të gjitha thëniet e trupit gjykues dhe pjesëmarrësve në seancën gjyqësore. Sekretari gjyqësor identifikon me saktësi në transkript çdo folës.
- Trasnkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor.
- Nëse senaca gjyqësore është zhvilluar në praninë e një përkthyesi, transkripti nënshkruhet edhe nga përkthyesi, për të vërtetuar saktësinë e përkthimit.”

Neni 7

Neni 119 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 120 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 120

Format e dokumentimit në raste të veçanta

1. Gjykata vendos të bëhet përpilimi i procesverbalit në formë të përmbledhur kur veprimet që duhet të pasqyrohen kanë përmbajtje të thjeshtë ose kur mungojnë mjetet teknike të regjistrimit ose ndihmësit teknikë.
2. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur, gjykata kujdeset që të shënohen pjesët thelbësore të deklarimeve dhe rrethanat në të cilat janë bërë.”

Neni 9

Neni 121 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 121

Deklarimet verbale të palëve

1. Kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa ose deklarime verbale. Kur është rasti, prokura e posaçme i bashkangjitet dosjes gjyqesore.
2. Palës që e kërkon, i lëshohet me shpenzimet e veta kopja e deklarimeve të bëra.”

Neni 10

Neni 122 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 122

Pavlefshmëria e procesverbalit dhe regjistrimit

1. Procesverbali është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.
2. Regjistrimi me mjete audio ose audiovizive është i pavlefshëm, vetëm për pjesën në të cilën përmbajtja e regjistrimit nuk kuptohet.”

Neni 11

Në nenin 140, pas pikës 6, shtohet pika 7, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“7. Nëse i pandehuri ka marrë njoftimin rregullisht për t’u paraqitur për njoftimin e akuzës e njohjen me aktet dhe nuk paraqitet brenda orës 24:00 të ditës kur duhej të ishte paraqitur, akuza quhet e njoftuar. Prokurori vijon me mbylljen e procedurës së hetimit paraprak dhe dërgimin e çështjes në gjykatë.”

Neni 12

Pas pikës 3, të nenit 215, shtohen pikat 4, 5, 6, dhe 7 me këtë përmbajtje:

“4. Prokurori i çështjes, urdhëron asgjësimin e sendeve të cilat janë të ndaluara për prodhim, posedim, mbajtje apo tregtim, kur ruajtja e tyre është e vështirë, kur ruajtja e tyre është veçanërisht e kushtueshme ose kur ruajtja e tyre përbën rrezik për sigurinë, shëndetin apo higjienën publike. Prokurori urdhëron ruajtjen e një apo më shumë kampioneve dhe asgjësimin e sendeve që mbeten.

5. Prokurori informon mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht mbi vendin dhe datën ku mund të merren kampionet të paktën 48 orë përpara. Mosparaqitja e mbrojtësit për të marrë kampionet nuk ndalon organin procedues për marrjen e tyre.

6. E gjithë sasia e sendeve fotografohet, filmohet, matet dhe peshohet sipas rastit, duke u dokumentuar të gjitha veprimet në procesverbalin që i bashkëlidhet dosjes hetimore. Procesi i marrjes së kampioneve nga tërësia e sendeve gjithashtu fotografohet dhe filmohet, duke dokumentuar veprimet në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim. Procesverbali i bashkëlidhet dosjes hetimore dhe i paraqitet gjykatës si provë, së bashku me kampionet e ruajtura.

7. Për sendet e sekuestruara objekt hetimi, mbajtja e të cilave çon në degradimin e tyre, prokurori disponon me vendim për shitjen e tyre në ankand, sipas legjislacionit në fuqi. Vlera e shitjes ngrihet në një llogari bankare të veçantë, deri në përfundimin e çështjes.”

Neni 13

Në nenin 227, pas pikës 1, shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Masat shtrënguese dhe ndaluese mund të jepen në mënyrë kumulative, të kombinuara.”

Neni 14

Në nenin 228, pas pikës 3, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Parashikimet e gërmave “a”, “b)” dhe “c)” të pikës 3 të këtij neni, duhet të jenë të vërtetuara me prova dhe për çdo masë të caktuar të jetë çmuar qartë fakti se përse zbatimi i masave të tjera më të lehta është i papërshtatshëm.”

Neni 15

Në nenin 230, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Askush nuk mund t`u nënshtrohet masës së arrestit me burg, në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston të paktën një provë direkte në morinë e provave, të cilat i janë nënshtuar verifikimit për vërtetësinë dhe saktësinë e tyre dhe që provojnë lidhjen e veprimeve/mosveprimeve me pasojën e ardhur.”

b) Pika 2 dhe 3, ndryshohen me këtë përmbajtje:

“2. Nuk mund të vendoset arresti me burg:

a) Ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë deri në 2 vjeç;

b) Ndaj një personi me gjendje shëndetësore të rëndë;

c) Ndaj grave mbi moshën 60 vjeç dhe burrave mbi moshën 65 vjeç;

ç) Ndaj një personi toksikoman apo të alkoolizuar, ndaj të cilit është duke u zbatuar një program terapeutik në një institucion të posaçëm, deri në përfundim të terapisë.

Kriteret e lartpërmendura nuk janë detyruese ndaj personave përsëritës në të njëjten vepër penale apo në një vepër më të rëndë, si dhe për personat që shkelin urdhërimet e parashikuara në urdhrin e gjykatës për masën e sigurimit të caktuar më parë, apo rasteve të tjera të parashikuara në këtë Kod.

3. Në rastet e parashikimeve të germave “a)” deri në “ç)” të pikës 2, "arresti në burg" mund të vendoset për krime që në minimumin e tyre kanë jo më pak se 5- vjet burgim.”

Neni 16

Në nenin 232, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“1. Masat shtrënguese, nga më e lehta, tek më e rënda, janë:”

b) Pas shkronjës “ç)”, të pikës 1, shtohet shkronja “ç/1)”, me këtë përmbajtje:

“ç/1) vendosja e hipotekës si garanci reale mbi pasurinë e të pandehurit.”

Neni 17

Pas pikës 1, të nenit 236, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Shuma e të hollave përcaktohet nga gjykata duke mbajtur në konsideratë marzhet e mëposhtme:

a) Për vepra penale që dënohen me gjobë ose deri në 5 vjet burgim, garancia pasurore caktohet deri në pesëqind mijë lekë.

b) Për vepra penale që dënohen nga 5 deri në 10 vjet burgim, garancia pasurore caktohet nga pesëqind mijë deri në një milion lekë.

c) Për vepra penale që dënohen nga 10 deri në 20 vjet burgim, garancia pasurore caktohet nga një milion deri në tre milion lekë.

d) Për vepra penale që dënohen me mbi 20 vjet burgim, garancia pasurore caktohet nga tre milion deri në pesë milion lekë.

Neni 18

Pas nenit 236, shtohet nenit 236/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 236/1

Vendosja e hipotekës si garanci reale mbi pasurinë e të pandehurit

1. Vendosja e hipotekës si garanci reale mbi pasurinë e të pandehurit është regjistrimi i barrës hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme në pronësi ose bashkëpronësi të të pandehurit, ose të afërmve të tij deri në shkallë të dytë, me kërkesën e tij. Për regjistrimin e hipotekës zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

2. Vendosja e hipotekës si garanci reale, bëhet kur i pandehuri nuk ka mundësi të depozitojë një garanci pasurore. Në çdo rast, barra hipotekore regjistrohet në masën që i korrespondon shumës që do të depozitohet si garanci pasurore, sipas nenit 236 të këtij Kodi.

3. Paraprakisht gjykatës i paraqitet një deklaratë noteriale e nënshkruar nga i pandehuri, ose personi që ka në pronësi pasurinë e paluajtshme, me të cilën deklaron se pranon të vendosë garancinë reale mbi pasurinë dhe është i vetëdijshëm që me mos paraqitjen e të pandehurit në organin procedues, garancia reale kalon në dobi të shtetit.

4. Pas paraqitjes së dokumentit dhe pas dëgjimit të prokurorit, gjykata urdhëron zbatimin e vendimit.

5. Në rast mosparaqitjeje në orën 24:00 të ditës së caktuar, apo shmangieje nga drejtësia, pasuria e paluajtshme, me kërkesë të Prokurorit, kalon me vendim të gjykatës në dobi të shtetit.

Neni 19

Pika 1, e nenit 253, riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik i keqeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit ndaj të cilit ka prova se ka kryer një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet.”

Neni 20

Pas nenit 259, shtohet neni 259/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 259/1

Masa e sigurimit në rastin e flagrancës

1. Personi i arrestuar në flagrancë mbahet me masë arresti në burg jo më shumë se 30 ditë. Prokuroria, brenda 30 ditëve dërgon në gjykatë kërkesën për gjykim.

2. Në rast se prokuroria nuk dërgon kërkesën për gjykim brenda 30 ditëve, gjykata vetë ose me kërkesë, rivlerëson masën e sigurimit arrest me burg, duke caktuar një masë tjetër të sigurimit personal.

3. Masa e sigurimit arrest me burg, vazhdon vetëm kur prokurori, brenda afatit 30 ditor, ka dërguar kërkesën për gjykim.”

Neni 21

Në nenin 284, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1, shtohen nenet 84, 85, 95, 124, 126, 149, 161, 200, 235, 236, 237, 238, 242, 243, 271, 274, 291/1, 291/2, 316 dhe 317 të Kodit Penal.

b) Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 dhe 1/4 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, ndjekja penale bëhet me ankim nëse autori dhe i dëmtuari janë në lidhje të largët midis tyre dhe nuk ka bashkëjetesë apo lidhje varësie të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë midis tyre.

1/2. Për vepra penale të parashikuara nga nenet 134/1, 137, 143/1, 150, 159/1 e 290/1 të Kodit Penal, në rastet kur të dëmtuar janë persona fizik ose juridikë privatë, kur shuma e vjedhur apo dëmi i shkaktuar është deri në 50 mijë lekë, kur personi ka zëvendësuar ose kompensuar dënimin e shkaktuar, ka normalizuar marrëdhëniet me të dëmtuarin, tregon pendim të thellë dhe nuk është përsëritës, ndjekja penale mund të fillojë me ankimin e të dëmtuarit ose nëse ka filluar, i dëmtuari mund të tërheq kallëzimin ose ankimin në çdo fazë të procedimit.”

1/3. Për veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, kur vepra është konsumuar nga pjesëtarët e familjes, me kërkesë të të dëmtuarit, çështja pushohet.

1/4. Ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit edhe për veprat penale të parashikuara nga paragrafi parë i nenit 134, paragrafi i parë i nenit 143, kur të dëmtuar nga vepra penale janë persona fizikë ose juridikë privatë, kur shuma e mallrave të vjedhura është e vogël dhe nuk tejkalon masën prej 50 000 lekë, dhe kur personat që kanë kryer veprën penale e kanë zëvendësuar dëmin e shkaktuar, si dhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 158, 159, paragrafi i parë, dhe 161 të Kodit Penal, në rastet kur personat që kanë kryer veprën penale e kanë zëvendësuar dëmin e shkaktuar.”

c) Pas paragrafit 5, shtohet paragrafi 6, me këtë përmbajtje:

“5. Organi procedues, me kërkesën e njëres palë, i propozon palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim sipas ligjit për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke caktuar një afat për afat për arritjen e marrëveshjes, por në çdo rast jo më shumë se 45-ditë. Në rast se nuk arrihet marrëveshja, ndërmjetësi jurist i zgjedhur nga palët sipas ligjit, njofton me shkrim prokurorin lidhur me këtë fakt, i cili vijon ndjekjen penale.

Neni 22

Në fund të pikës 3, të nenit 324, shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Njoftimi bëhet brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, në adresën që disponohet për të pandehurin, ose në adresën e avokatit të zgjedhur prej tij. Mosgjetyja e të pandehurit nuk dëmton vijimin e hetimeve”.

Neni 23

Pas pikës 3, të nenit 325, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Nga çasti kur gjykata merr vendim për pranimin e ankesës kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve, prokurori ka dhjetë ditë kohë për të paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes, me materialet hetimore që ka në dorë”.

Neni 24

Në nenin 332, pika 1, germa “d”, pas togfjalëshit “dëshmia e penahitetit”, shtohet togfjalëshi “, dokumentin zyrtar të historikut të gjëndjes gjyqësore të subjektit, raportin e vlerësimit të Shërbimit të Provës”.

Neni 25

Pas nenit 341, shtohet neni 341/1 me përmbajtjen si vijon:

“Neni 341/1

1. Në rast se një avokat apo prokuror nuk është i pranishëm gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore pa ndonjë shkak të arsyeshëm ose pa të drejtë pengon apo vonon procedimin normal të seancave gjyqësore, Gjykata, me kërkesën e palës ose palëve pjesëmarrëse në gjykim, ose me nismën e vet, pas dëgjimit të avokatit ose prokurorit, përcakton nëse ka patur një pengesë për të marrë pjesë, apo mungesa apo vonesa e procedimit normal të Gjykatës ka qenë pa shkaqe të arsyeshme. Kryetari i trupit gjykues mund ta dënojë me gjobë deri në 50 000 lekë. Gjoba përcaktohet në proporcion me dëmin e shkaktuar nga dështimi për të marrë pjesë, nga pengimi i padrejtë, ose vonesa. Në çdo rast, gjoba i njoftohet dhomës së avokatëve, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Çdo vendim i marrë sipas pikës 1 të këtij neni përbën titull ekzekutiv. Ndaj çdo vendimi të marrë sipas këtij neni, mund të bëhet ankim brenda 15-ditëve në Gjykatën e Apelit, me përjashtim të vendimeve të marra nga Gjykata e Lartë. Një ankim i tillë, përveç nëse urdhërohet ndryshe nga Gjykata e Apelit, nuk do të veprojë si një shtyrje e ekzekutimit të vendimit.”

Neni 26

Neni 345, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 345

Procesverbali i seancës

1. Menjëherë pas mbylljes së seancës, procesverbali i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që e ka mbajtur, i paraqitet kryetarit për ta konfirmuar.
2. Procesverbali i seancës përfshihet në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor.”

Neni 27

Titulli i Nenit 347, riformulohet me këtë përmbajtje: **“Kërkesat e palëve për mbajtjen e procesverbalit fjalë për fjalë”**.

Neni 28

Në nenin 403, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Paragrafi i dytë i nenit 403, riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Kërkesa mund të bëhet vetëm nëse ka marrëveshje paraprake me shkrim me prokurorin për ofrimin e gjykimit të shkurtuar. Kërkesa me shkrim së bashku me marrëveshjen, depozitohet në sekretarinë e gjykatës të paktën tri ditë para datës së caktuar për seancën.

b) Pas paragrafit të dytë, shtohet paragrafi i tretë me këtë përmbajtje:

“3. Në çdo rast, marrëveshja ofrohet nga prokurori kur çështja paraqet vështirësi hetimi dhe i dënuari bashkëpunon në zbardhjen e të gjitha fakteve, rrethanave dhe ngjarjes.”

Neni 29

Në nenin 406, pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Kur jep vendim dënimi, vetëm kur ka marrëveshje me prokurorin, sipas përcaktimeve të nenit 403, gjykata mund të ulë masën e dënimit me burgim ose gjobë, deri me një të tretën. Për krime të rënda, masa e dënimit mund të ulet deri në një të katërtën. Dënimi me burgim të përjetshëm mund të zëvendësohet me tridhjetë e pesë vjet burgim.”

Neni 30

Neni 432 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 432

Rekursi kundër vendimeve të formës së prerë

1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

- a) ka dalë një provë e re, e cila nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë apo apel;
- b) kur ka provë për cenim të procesit të rregullt gjyqësor;

c) në rastin e një ligji me fuqi prapavepruese, për vendime të dhëna deri 3 vjet para hyrjes së tij në fuqi.

2. Në rastet e mësipërme, Gjykata e Lartë konstaton faktin dhe e kthen çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit.”

Neni 31

Në fund të pikës 1, të nenit 434, shtohet togfjalëshi “sipas nenit 432 të këtij Kodi. Në të kundërt, gjykata vendos dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara për unifikimin e praktikës gjyqësore.”

Neni 32

Neni 438 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 438

Unifikimi i praktikës gjyqësore

1. Për qëllim unifikimi të praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë, me nismën e saj, ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara një çështje në çdo fazë të gjykimit dhe e zgjidh atë në themel. Zgjidhja në këtë rast ka karakter unifikues.

2. Me kërkesë të kryetarit të gjykatës që gjykon çështjen ose gjyqtarit të çështjes, Gjykata e Lartë mund të tërheqë një çështje për unifikimin e praktikës gjyqësore, kur çmon se ka praktikë të ndryshme dhe për këtë qëllim mund të cenohet parimi i barazisë para ligjit.

3. Unifikimi i praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë, mund të kërkohet dhe nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, ose Prokurori i Përgjithshëm, për një çështje të caktuar, që lidhet me fushën e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

4. Gjykata e Lartë mund të vendosë unifikimin e praktikës gjyqësore, edhe kur është duke shqyrtuar një çështje, sipas nenit 432 të këtij Kodi.

5. Tërheqja e çështjeve me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal.

6. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin.

7. Vendimi i kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat e të gjitha niveleve në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Neni 33

Nenet 441, 442, 443, 444, dhe 445 shfuqizohen.

Neni 34

Në nenin 494, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 1, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Cilido person, shtetas shqiptar apo i huaj, për të cilin ka një urdhër ndërkombëtar arresti, arrestohet menjëherë.”

b) Në pikën 6, togfjalëshi “Masat shtrënguese revokohen” zëvendësohet me togfjalëshin “Masa e sigurisë arrest me burg, zëvendësohet me një masë tjetër, sipas titullit V të këtij Kodi.”.

c) Në fund të pikës 6, shtohen pikat, 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:

“7. Prokurori, brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, duhet të kryejë veprimet procedurale për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm që lidhen me mundësinë e ekstradimit ose jo. Në rast se Prokurori konstaton pamundësinë e ekstradimit për një nga arsyet e parashikuara në ligj, njofton Ministrinë e Drejtësisë. Njoftimi përmban informacionin mbi një nga procedurat alternative që do të vijohet.

8. Ministria e Drejtësisë, ia përcjell njoftimin shtetit të huaj që ka lëshuar urdhrin ndërkombëtar të arrestit.”

Neni 35
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
I L I R M E T A